



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE
DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1893 Prot

Tiranë më, 14.04.2016

Lënda: Raporti i monitorimit të performancës së produkteve të buxhetit të ILDKPKI, për 3 - mujorin e parë të vitit 2016.

Drejtuar: Znj. Gelardina PRODANI
NËPUNËS I PARË AUTORIZUES
MINISTRIA E FINANCAVE

TIRANË

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në zbatimin e buxhetit të shtetit për 3-mujorin e parë të vitit 2016, është mbështetur në kërkesat më të domosdoshme institucionale, në zbatim detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr.9049, datë 10.04.2003, "Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të Disa nëpunësve Publike", i ndryshuar dhe Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike" i ndryshuar .

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, në mbështetje të Ligjit nr.147/2015, "Për Buxhetin e vitit 2016" i është akorduar një fond i planifikuar prej 118 milion lekë, i cili përbëhet nga:

Fondi i Pagave 79 milion (zëri 600)

Fondi i Sigurimeve Shoqërore: 9 milion lekë (zëri 601)

Fondi për Shpenzime Operative: 25 milion e 760 mijë lekë (zëri 602)

Fondi për Investime: 4 milion lekë (zëri 231)

Transferime korrente: 240 mijë lekë (zëri 606)

Buxheti i akorduar për programin "Menaxhim, Administrim, Palanifikim", është i mbështetur në Deklaratën e Politikës të hartuar gjatë procesit të PBA 2016-2018, program i cili do të mbështesë me fonde buxhetore realizimin e misionit të ILDKPKI.

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, në zbatim të Udhëzimit nr.1, datë 15.1.2016,, "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016", për periudhën e raportuar, Inspektorati i Lartë ka realizuar vlerën buxhetore në 22,799,301 lekë leke ose 68.67%, të fondit të planifikuar për 3-mujorin e parë të vitit 2016.

Llog. Ek	Peshkrimi	Plani Buxheti vjetor 2016	Plani Buxheti 3-Mujor 1.2016	Buxheti Irealizuar 3-Mujori i pare viti 2016	Prokuruar 3-Mujori i pare viti 2016	Realizimi % si 3-Mujor
600	Fond Page	79,000.0	19,600,000	18,313,794		93.4%
601	Kontrib. Sig. Shoq. & Shëndetësore	9,000.0	2,700,000	2,563,623		94.9%
602	Shpenzime operative	25,780.0	8,840,000	1,861,884	6,425,742	27.2%
606	Transferime per financim transporti	240.0	60,000	60,000		100.0%
231	Investime	4,000	4,000,000	-	1,600,000	0.0%
	Totali	118,000.0	33,200,000	22,799,301	8,025,742	68.67%

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, (zeri 600-601), është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë 3-mujorit të parë të vitit 2016, numri mesatar i punonjësve është realizuar 59 vetë, nga 60 vetë të miratuar.

Fondi i përgjithshëm i pagave për këtë periudhë, është realizuar për numrin faktik të punonjësve në vlerën 18,313,794 lekë ose 93.4% e fondit të planifikuar për periudhën Janar-Mars 2016 dhe për kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në vlerën 2,563,623 lekë ose 94.9%, e planifikimit për periudhën respektive.

Mosrealizimi i këtij fondi ka ardhur si rezultat i mosplotësimit të një vendi pune në pozicionin Inspektor gjatë kryerjes së procedurave të rekrutimit në 3-mujorin e parë, në mbështetje të planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin Civil" i ndryshuar dhe dispozitave ligjore në mbështetje të tij.

Fondi për shpenzime në zerin investime (zeri 231) ,

Vlera e përgjithshme e planit të fondit të investimeve për vitin 2016 është 4 milion lekë. Për 3-mujorin e parë të periudhës respektive ky fond është prokuruar gjithsej në vlerën 1.6 milion lekë, ose 40% e planit 3-mujor.

Inspektorati i Lartë, në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi dhe të planifikimit në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të vitit 2016, për këtë zë shpenzimi ka prokuruar fondet e planifikuara, për fondet e investimeve të vëna në dispozicion si;

1. Fondi i investimeve me objekt "Blerje pajisje kompjuterike dhe elektronike", miratuar si produkt nga Ministria e Financave, në vlerën 1,600,000 lekë është prokuruar me procedurën kërkesë për propozim dhe fituar nga shoqëria "CCS" shpk, në vlerën 1,436,882.4 lekë me tvsh, ose 89.8%. Likujdimi do të kryhet në mbështetje të kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, datë 8.4.2016.
2. Fondi i investimeve me objekt "Sistem Kamera Survejimi" dhe "Faqe Web", të miratuar si produkte nga Ministria e Financave me shkresën nr.17761/246 prot, datë 25.1.2016 "Dërgohet rmiratimi i detajimit të investimeve për vitin 2016", do të prokurohet gjatë periudhës në vazhdim në zbatim të dispozitave ligjore financiare në fuqi dhe planifikimit në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike të vitit 2016.

Fondi për shpenzime në zerin Mallra dhe Shërbime (zeri 602),

Edhe për këtë zë, për periudhën respektive është realizuar gjithsej vlera prej 1,861,884 lekë ose 27.2% e planifikimit 3-mujor dhe prokuruar vlera prej 6,425,742 lekë ose 93.94 % e fondit të planifikuar si 3-mujor. Në respektim të dispozitave ligjore në fuqi, likujdimi do të kryhet çdo muaj në mbështetje të kontratave të lidhura ndërmjet palëve.

Për këtë periudhë të vitit 2016, në realizimin e shpenzimeve operative, Inspektorati i Lartë është mbështetur në realizimin e kërkesave të cilat lidhen me;

1. Në realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa, energji elektrike, uje, shërbime postare e telefonike, në funksion të një veprimtarie normale institucionale të cilat për periudhën e raportuar janë realizuar 100% të fondit të planifikuar si 3-mujor.
2. Realizimin e shpenzimeve për blerje materiale e shërbime mirëmbajtje, sipas nevojave konkrete, për krijimin e kushteve të një aktiviteti normal institucional.

Ka përfunduar prokurimi me tender me procedurën kërkesë për propozim, me objekt shërbim me roje civile dhe konkretisht është prokuruar;

- Fondi me objekt "Shërbim me roje civile", për nevojat e fillimi të vitit është kryer procedura e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake për periudhën Janar-Mars 2016, me subjektin privat "Nazeri 2000" shpk në vlerën 775,841 lekë me tvsh, dhe realizuar 64.9 % e fondit limit të planifikuar.
- Fondi me objekt "Shërbim me roje civile", prokurimi i të cilit është realizuar 79.5% e fondit limit të planifikuar, fituar nga subjekti privat "Myrto Security" shpk, në vlerën 2,385,668 lekë me tvsh. Likujdimi do të kryhet çdo muaj, sipas kushteve të kontratës së lidhur ndërmjet palëve, datë 4.4.2016.
- Fondi me objekt "Blerje Kancelari", prokurimi i të cilit është realizuar 65.9 % e fondit limit të planifikuar, fituar nga subjekti privat "Infosoft Office" shpk, dhe likujduar në vlerën 1,118,341 lekë me tvsh.

Gjatë këtij 3-mujori janë realizuar me blerje të vogël, sipas procedurës elektronike prokurimi dhe realizimi i blerjeve materiale dhe shërbime të tjera.

Realizimi i te ardhurave nga veprimtaria e ILDKPKI.

Të ardhurat nga veprimtaria e ILDKPKI, vijnë kryesisht nga;

1. Arkëtimi i gjobave të vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore, nga zyrtarë subjekt të ligjit të deklarimit dhe kontrollit të pasurive, të institucioneve të ndryshme, të cilat për 3-mujorin e parë të vitit 2016, janë 29 raste, në vlerën 3,475,000 lekë.
2. Zyrtar Përmbarimore të rretheve për ekzekutimin e vendimeve të gjykatave, për gjobat e vendosura për rastet e shkeljes së detyrimeve ligjore nga zyrtarë subjekt të ligjit. Për periudhën respektive të vitit 2016, janë ekzekutuar tërësisht gjithsej 19 raste, në vlerën 1,800,000 lekë, nga të cilat 15 raste në vlerën 1,600,000 lekë kanë kaluar në llogarri të të ardhurave të ILDKPKI. Arkëtimi në favor të ILDKPKI, të 4 rasteve të tjera, të cilat përbëjnë vlerën 200,000 lekë, është në proces likuidimi.
3. Të ardhura të tjera të cilat për periudhën respektive, janë në vlerën 20,880 lekë.

Gjithsej të ardhurat të arkëtuara për 3-mujorin e parë të vitit 2016, janë në vlerën 5,095,880 lekë. Të gjitha këto të ardhura, të realizuara në zbatim të ligjeve organike mbi të cilat funksionon Inspektorati i Lartë dhe të VKM nr.432 dt.28.06.2006 “Mbi të ardhurat në Institucionet Buxhetore”, kalojnë në Buxhetin e Shtetit në masën 100%.

Për periudhën në vazhdim në mbështetje të kërkesave në rritje, për përmirësim e mëtejshëm të punës në zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara, do të zbatojmë me korrektesi të gjitha detyrimet që rrjedhin nga ligji për deklarimin dhe parandalimin e konfliktit të interesave private të zyrtareve, si dhe legjislacionin financiar në fuqi.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Flori KARAJ





Raportet e Monitorimit

Buxheti 2016

Shtojca Nr.7: Raporti i Shpenzimeve Faktive të Programit sipas Artikujve Buxhetorë

ne 000 leke

Institucioni	Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit			Kodi i Grupit 76
Programi	Planifikim, Menaxhim ,Administrim		Totali I Shpenzimeve	
Artikulli kodi	Emri	PBA 2015	Fakti 3-Mujori I Viti 2016	Diferenca 2015
600	Paga	79,000.0	18,313.80	60,686.20
601	Sigurime Shoqërore	9,000.0	2,563.60	6,436.40
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	25,760.0	1,861.90	23,898.10
603	Subvencione			
604	Transferta Korente të Brendshme			
605	Transferta Korente të Huaja			
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	240.0	60.00	
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	114,000.0	22,799.30	91,200.70
230	Kapitale të Patrupëzuara			
231	Kapitale të Trupëzuara	4,000.0	-	4,000.00
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale	4,000.0	0.00	4,000.00
Totali	Korrente dhe Kapitale	118,000.0	22,799.30	95,200.70
Jashte Buxhetore		0.0	0.0	-
Totali (korrente + kapitale + jashte buxhetore)		118,000.0	22,799.30	95,200.70

Drejtuesi I	Emri:	Flori KARAJ	Sekretari i	Emri:	Flori KARAJ
Ekipit Menaxhues Te Programit	Nenshkrimi		Pergjithshem	Nenshkrimi	



Raportet e Monitorimit

Buxheti 2016

Shtojca Nr.8: Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve

ne 000 leke

Institucioni	Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit				Kodi i Grupit 76	
Programi	Planifikim, Menaxhim ,Administrim			Totali I Shpenzimeve		
Programi		PBA PLAN 2016	Buxhet 2016	Buxheti Perfundimtar 2016	Fakti 3-mujori 2016	Diferenca 2016
Titulli	Emri					
01110	Planifikim, Menaxhim ,Administrim	118,000.00	118,000.00	118,000.00	22,799.30	95,200.70
Totali	Shpenzime të miratuara	118,000.0	118,000.0	118,000.0	22,799.30	95,200.70

Sekretari i Pergjithshem	Emri:	Flori KARAJ
	Nenshkrimi	
	Data	14.4/2016





Raportet e Monitorimit

Buxheti 2016

Shtojca Nr.9 "Raporti i Realizimit të Rezultateve të Programit

ne 000 leke

Institucioni	Inspektorati i Larte i deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit				Kodi i Grupit	76		
Programi	Planifikim, Menaxhim ,Administrim	Titulli	01110					
Kodi	Emri i Rezultatit	Njesi Matese	Sasia e Planifikuar	Sasia prokuruar	Realizimi			Komente
					Plotesisht	Pjeserisht	Aspak	
M760024	Blerje Paisje Kompjuterike dhe Elektronike	000/leke	1,600,000	1,600,000.0			x	Proces lidhje kontrate
M760039	Sistem Kamera Survejimi	000/leke	2,250,000				x	Per periudhen ne vazhdim
M760040	Faqe Web	000/leke	150,000				x	Per periudhen ne vazhdim
Totali (kapitale)			4,000,000.0	1,600,000.0	-	-		

Drejtuesi I	Emri:	Flori KARAJ	Sekretari i	Emri:	Flori KARAJ
Ekipit Menaxhues	Nenshkrimi:		Pergjithshem	Nenshkrimi:	
Te Programit	Data:	14.4.2016		Data:	14.4.2016



Raportet e Monitorimit

Buxheti 2016

Shtojca Nr.10: Raporti I i Shpenzimeve Faktike te Programit sipas Rezultateve

Institucion	Inspektorati I Larte I deklarimit dhe Kontrollit te Pasurive dhe Konfliktit te Interesit						Kodi i Grupit	76
Programi	Planifikim, Menaxhim ,Administrim	Titulli	01110					
Kodi	Emri I Rezultatit	Shpenzimet e Rezultatit				Kosto per njesi		
		PBA	Pl.Buxheti	Pl.Buxheti	Fakti	Kosto per njesi	Kosto per njesi	Shpjegime
Rezultatit	Emri I Rezultatit	Plan 2016	2016	Perfundimtar 2016	3-M i Pare i proku	Plan 2016	Fakt 2016	Shpjegime
M760024	Blerje Paisje Kompjuterike dhe Elektronike	1,600	1,600	1,600,000	1,600,000	123,076.90	110,529.40	Proces lidhje kontrate
M760039	Sistem Kamera Survejimi	2,250	2,250	2,250,000				
M760040	Faqe Web	150	150	150,000				
		4,000.0	4,000.0	4,000,000.0	1,600,000.00			

Drejtuesi I	Emri:	Flori KARAJ	Sekretari i	Emri:	Flori KARAJ
Ekipit Menaxhues	Nenshkrimi		Pergjithshem	Nenshkrimi	
Te Programit	Data:	14.4.2016		Data:	14.4.2016

